




Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 30

Datë 21-09 2022

KONTRATË PROKURIMI NR 16

62500-22-2337-2-3-6/C474

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe

FLURIM XHYLIQI, MARALI, MALISHEVË, 1174850786, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

SHËRBIME KONSULENTE - NJË KONSULENT PËR DREJTORIN E FINANCAVE DHE BUXHET me numër identifikues : 62500-22-2337-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

SHËRBIME KONSULENTE - NJË KONSULENT PËR DREJTORIN E FINANCAVE DHE BUXHET

No.	Lot
1	SHËRBIME KONSULENTE - NJË KONSULENT PËR DREJTORIN E FINANCAVE DHE BUXHET

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 5 304,00 €; [pesëmijëetreqindëkatëreuro] Euro.

Pagesa ofruesit të shërbimeve do të bëhet nga data 1-5 në fillim të çdo muaji nga 442.00€

(katërqindëkatërdhjetëdeyuro) dhe nga kjo shumë ofruesi i shërbimeve duhet të kryej obligimet tatimore në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIP në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Flurim Xhyliqi
Pozita:	Menaxheri i Prokurimit	Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 62500-22-2337-2-3-6/C474

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: SHQIPE .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është : 21.04.2022 .
	6.4	Data e Përfundimit është : 21.04.2023
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është : Komuna Malishevës – në Drejtorin për Ekonomi dhe Financa .
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i kontratës është : z.Esma Gashi - Zyrtare e Ekonomisë e caktuar nga ZKA i AK-së . Menaxheri i ofruesit të shërbimeve është përgjegjës për mbikqyrjen e ofruesit të shërbimeve për tërë periudhën sa zgjatë kontrata duke filluar nga dita e parë e fillimit të shërbimeve deri në përfundimin e kontratës. Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë kryerjen e shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve.
<u>Detyrat kryesore të Konsulentit :</u>	12.4	• Pranimi e lëndëve; • Regjistrimi i lëndëve në sistem; • Mbajtja e evidencave të lëndëve ; • Nxjerrja e raporteve; • Bashkëpunimi me të gjithë stafin e drejtorisë.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <i>[shëno përqindjen e Çmimit të Kontratës]</i> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: EUR .

Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë [shëno shumën] b) Përgjegjësia e Palës së Tretë [shëno shumën] c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve [shëno shumën] d) Përgjegjësia profesionale [shëno shumën] e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës [shëno shumën]
Orari i punës		• I angazhuari do të punojë dyzetë (40) orë në javë, prej të Hënës deri të Premten sipas orarit 08:00 - 16:00, brenda një periudhe prej 12 muaj.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Pagesa ofruesit të shërbimeve do të i bëhet nga data 1-5 në fillim të çdo muaji nga 442.00€ (katërqindëkatërdhjetëeuro) dhe nga kjo shumë ofruesi i shërbimeve duhet të i kryej obligimet tatimore në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: [shëno] Periudha Garantuese e Defekteve është [shëno datën]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Komisioni për ndërmjetësim pranë Ministris së Drejtësis.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Datë : 03.03.2022.

SPECIFIKACION

Nr.	Titulli i pozitës së punës	Sasia	Muaj	Koeficienti (6)	Totali
1.	Zyrtar (konsulent) për DEFB	1	12	442.00€	5,304.00€
TOTALI :					5,304.00€

FLURIM XHYLIQI - *Xhyliqi*